



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-053

Prishtinë, më 5 mars 2012, në orën 15:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË TË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 5 MARS 2012

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Petar Miletqi dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Sasha Millosavleviq dhe Albert Kinolli.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Shefki Shoshaj dhe Shefqet Rexhepi;

Nga OSBE-ja, Lejla Selimi.

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe tre pika shtesë, të cilat i miratoi Kryesia.

Kryesia, me propozim të kryetarit, miratoi këtë

R e n d d i t e

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 27 shkurt 2012,
2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 27 shkurt 2012

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 27 shkurt 2012, u miratua pa vërejtje.

2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës

Kryesia, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që mbledhja plenare e radhës të mbahet të enjten, më 15 mars 2012, ndërsa agjenda për këtë mbledhje plenare do të caktohet në mbledhjen e radhës së Kryesisë me shefat e grupeve parlamentare.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave

1. Kërkesa e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, për debat parlamentar lidhur me marrëveshjen për përfaqësim rajonal të Republikës së Kosovës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e cekur më lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Peticioni i qytetarëve lidhur me marrëveshjen për përfaqësimin rajonal të Republikës së Kosovës i dërgohet për shqyrtim Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione.

2. Njoftimi i Grupit Parlamentar 6+, për ndërrimin e kryetarit të këtij grupi parlamentar me rrotacion

Kryesia u njoftua me propozimin e Grupit Parlamentar 6+ se kryetar i këtij grupi prej 1 marsit 2012 është deputeti Albert Kinolli nga radhët e Partisë Rome PREBK, në vend të deputetes Duda Balje.

3. Njoftimi i Komisionit për Legjislacion për caktimin e një deputeti për anëtar në Komisionin Qeveritar për njohjen e statusit të ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë

Kryesia, u njoftua nga Komisioni për Legjislacion lidhur me caktimin e deputetit Halit Krasniqi për anëtar në Komisionin Qeveritar për njohjen e statusit të ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë.

4. Kërkesa e Asociacionit të Gazetarëve Profesionistë të Kosovës lidhur me informimin për ndryshimet e Rregullores për rendin dhe qasjen e mediave në punën e Kuvendit të Republikës së Kosovës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e cekur më lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Jakup Krasniqi, do të organizojë një takim me përfaqësuesit e Asociacionit të Gazetarëve Profesionistë të Kosovës, më. 9 mars 2012, në orën 15:00.

Pikat shtesë:

1. Kërkesa e Grupit të Grave Deputete të Kuvendit të Republikës së Kosovës për seancë të veçantë pune, më 8 mars 2012, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e Grupit të Grave Deputete të Kuvendit të Republikës së Kosovës për seancë të veçantë pune më 8 mars 2012, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas, vendosi që seanca plenare të mbahet më 9 mars 2012, në orën 11:00, me këtë

Rend dite

Debat parlamentar me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas

2. Kërkesa e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, për lejimin e vizitës zyrtare të Komisionit për Mbrojtje dhe Siguri të Parlamentit Hungarez

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, për të ftuar Komisionin për Mbrojtje dhe Siguri të Parlamenti të Hungarisë, për vizitë zyrtare në Kosovë, prej 3-6 prill 2012.
2. Shpenzimet e akomodimit dhe ushqimit për delegacionin e lartpërmendur gjatë kësaj vizite zyrtare Kosovë, do të mbulohet nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Ngarkohet Divizioni i Buxhetit që ta zbatojë këtë vendim.

3. Ftesa e Jozefina Topalli, Kryetare e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

Kryesia, pasi shqyrtoi ftesën e cekur më lart, mori këtë

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi i deputeteve të Kuvendit të Republikës së Kosovës në këtë përbërje: Flora Brovina, Myzejene Selmani, Lirije Kajtazi, Kymete Bajraktari dhe Alma Lama, në Shqipëri, me 8 mars 2012.
2. Shpenzimet e udhëtimit, ushqimit, si dhe mëditjet shtesë për të lartpërmendurat në paragrafin 1 (një) të këtij vendimi, mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës.
3. Ngarkohet Divizioni i Buxhetit që ta zbatojë këtë vendim.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë, në orën **16:00** minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale